



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA/MINISTRY OF
HEALTH**

**UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 03 / 2024 - BASHKË PAGESAT PËR
SHËRBIMET SHËNDETËSORE**

Ministri i Shëndetësisë në bazë të nenit 58 të Ligjit për Shëndetësi Nr. 04/L-125 (GZ/Nr.13 / 07 Maj 2013), nenit 11 paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (GZ/Nr. / Nr. 34 / 18 Nëntor 2022, nxjerrë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 03 / 2024 BASHKË PAGESAT PËR SHËRBIMET SHËNDETËSORE

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është të përcaktojë bashkë pagesat për kujdes shëndetësor për qytetarin dhe banorin, përjashtimet nga bashkë pagesa si dhe obligimet e institucioneve shëndetësore publike për mbledhjen e bashkë pagesave.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e këtij udhëzimi zbatohen për çdo qytetar dhe banor, si dhe për institucionet publike shëndetësore në Republikën e Kosovës.

Neni 3 Përkufizimet

Të gjitha shprehjet e përdorura në këtë udhëzim kanë kuptimin e njëjtë me legjislacionin në fuqi për shëndetësi dhe legjislacionin tjetër përkatës.

Neni 4 Bashkë pagesat për shërbime shëndetësore

1. Institucionet shëndetësore publike obligohen të mbledhin bashkë pagesat nga qytetari, banori dhe rezidenti me rastin e ofrimit të kujdesit shëndetësor.
2. Institucionet shëndetësore publike që mbledhin bashkë pagesa janë institucionet e nivelit parësor, dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor.
3. Çdo institucion shëndetësor duhet të vendos çmimoren e bashkë pagesave dhe njoftimin për kategoritë e qytetarëve që janë të liruara nga bashkë pagesa.
4. Për kryerjen e shërbimeve të cilat janë në listën e bashkë pagesave të shërbimeve shëndetësore, shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore të liruar nga bashkë pagesat sipas këtij udhëzimi administrativ, u lëshohet dëftesa me numër serik, manuale ose elektronike, ku shënohet shuma e bashkë pagesës në vlerë në prej 0.00 euro, në numra dhe me shkronja “zero” euro.

5. Dëftesa përmban të dhënat e përgjithshme të pacientit, duke përfshirë edhe numrin personal, diagnozën, shërbimin dhe/apo procedurën, të emërtuar dhe koduar sipas Klasifikimit Ndërkombëtar përkatës.
6. Në protokolin e pacientëve dhe në dosjen elektronike të pacientit evidentohen të dhënat e lidhura me lirimin nga bashkë pagesa, kodi i lirit, lloji i dokumentit dhe numri i dokumentit në bazë cilit është liruar nga bashkë pagesa.
7. Çdo institucion shëndetësor, evidenton në mënyrë të saktë të gjitha mjetet e mbledhura nga bashkë pagesat e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore sipas llojeve të shërbimeve për të cilat është kryer bashkë pagesa.
8. Të gjitha mjetet financiare të mbledhura nga institucioni shëndetësor nga bashkë pagesat prej shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore, depozitohen çdo ditë të punës, për çdo ditë të javës, ndaras.
9. Një kopje e të gjitha fletëpagesave, se bashku me deklaratën që e pasqyron tërësinë e mjeteve financiare të mbledhura, dorëzohen në arkën e institucionit shëndetësor përkatës.
10. Shpenzimi i mjeteve të mbledhura nga bashkë pagesat, bëhet sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësisë.

Neni 5

Kategoritë e qytetarëve dhe banorëve të liruara nga bashkë pagesat

1. Kategoritë e qytetarëve dhe banorëve të liruara nga bashkë pagesat sipas Ligjit për shëndetësi, janë:
 - 1.1. Personat që kanë të ardhura më të ulëta se niveli zyrtar i ndjeshmërisë sociale i përcaktuar nga Qeveria, në kategoritë e individëve të regjistruar si të ndjeshëm në aspektin social ose si të varfër, në bazë të aktit nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria përkatëse për Mirëqenie Sociale.
 - 1.2. Viktima të trafikimit gjatë vitit të parë pas regjistrimit zyrtar, në pajtim me ligjin;
 - 1.3. Banorët e përhershëm të vendbanimeve joformale në Republikën e Kosovës që nuk janë të regjistruar ose të cilët janë në proces të regjistrimit deri në përfundim të procesit të regjistrimit, ose deri një (1) vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, çfarëdo realizohet më parë;
 - 1.4. Personat e ri-atdhesuar bazuar në marrëveshjet bilaterale të Republikës së Kosovës me shtetet e tjera, në vitin e parë pas ri-atdhesimit;
 - 1.5. Të burgosurit të cilët janë në mbajtje të dënimit;
 - 1.6. personat të ç'vendosur me dhunë jashtë shtëpive të tyre si viktima të dhunës familjare, gjatë vitit të parë pas regjistrimit zyrtar, në pajtim me ligjin.
 - 1.7. Dhuruesit e gjakut që posedojnë dëshminë e lëshuar nga QKKTGJ (Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut) se kanë dhënë gjak së paku pesë (5)

herë në dy (2) vitet e fundit. Dhuruesit me numër më të vogël të dhurimit të gjakut lirohen për 12 muaj të ardhshëm nga data e dhurimit të fundit.

2. Kategoritë e qytetarëve dhe banorëve të liruar nga bashkë pagesat sipas ligjeve tjera përkatëse në fuqi, janë:

- 2.1. Pensionistët e moshës dhe ata kontributdhënës;
- 2.2. Pensionistët e kompensë “Trepça”;
- 2.3. Pensionistët e Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës;
- 2.4. Ish të burgosurit politik si dhe bashkëshortja dhe fëmijët e tyre;
- 2.5. Viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës;
- 2.6. Personat me aftësi të kufizuar;
- 2.7. Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe anëtarët e familjes së ngushtë;
- 2.8. Anëtarët e familjes së ngushtë të dëshmorëve;
- 2.9. Anëtarët e familjes së ngushtë të zhdukurve të UÇK-ës dhe të zhdukurve civil;
- 2.10. Pjestarët e UÇK-së dhe anëtarët e familjes së ngushtë;
- 2.11. Viktimat civile të luftës dhe anëtarët e familjes së ngushtë;
- 2.12. Invalidi i UÇK-së dhe anëtarët e familjes së ngushtë;
- 2.13. Familjet e varfra nën asistencë sociale - të gjithë anëtarët e familjes;
- 2.14. Individët të cilët janë duke jetuar në institucione shtetërore -fëmijët nën kujdes dhe nën kujdestari, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara të strehuar në shtëpitë për persona të moshuar, si dhe në shtëpitë për integrim në komunitet;

Neni 6 **Referimi dhe bashkë pagesat**

1. Me qëllim të shfrytëzimit racional të shërbimeve shëndetësore, shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore duhet të respektojnë sistemin e referimit.
2. Mënyra e referimit bëhet në përputhje me hierarkinë organizative dhe strukturore të niveleve të sistemit të kujdesit shëndetësor, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Referimi i brendshëm është referimi kur mjeku familjar kërkon shërbim konsultativ ose shërbime me qëllime diagnostike të cilat kryhen brenda institucioneve të KPSH (QKMF, QMF, AMF).

4. Referimi i jashtëm është udhëzimi i pacientëve jashtë shërbimeve të KPSH, kur mjeku familjar dhe stomatologu kërkon shërbim konsultativ, prej specialistëve të kujdesit dytësor dhe tretësor shëndetësor, apo procedura diagnostike/terapeutike që nuk mund të ofrohen në kuadër të shërbimeve të KPSH.

5. Referimi i pacientit në nivelet më të larta të kujdesit shëndetësor bëhet me dokumentacion unik shëndetësor dhe udhëzohet vetëm nga mjeku familjar/doktori i mjekësisë dhe stomatologu.

6. Në rastet kur personi ballafaqohet me urgjencë- emergjencë shëndetësore e cila e mund të kërcnoj jetën dhe shëndetin, ai mund të shkoj apo të dërgohet në institucionin më të afërt të kujdesit shëndetësor apo në institucionin që konsiderohet si më i përshtashmi, duke pasur parasysh natyrën urgjent-emergjente të rastit.

7. Qytetarët dhe banorët të cilët nuk respektojnë sistemin e referimit duhet të paguajnë për shërbimin sipas shtojcës përkatëse të këtij Udhëzimi.

Neni 7 Shtojca

1. Shtojcat 1, 2, 3, 4, 4A, 4B, 4C, 4D, 4E, 4F, 4F1, 4G, 5, 6, 7, 7A dhe 8 janë pjesë përbërëse të këtij udhëzimi administrativ.

2. Shtojcat nga paragrafi 1 i këtij neni plotësohen dhe ndryshohen me plotësim ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Bashkë Pagesat për Shërbimet Shëndetësore.

Neni 8 Dispozitat kalimtare

1. Deri në funksionalizimin e akteve juridike përkatëse, në kategoritë e liruar nga bashkë pagesa përfshihen edhe këto kategori të popullatës:

1.1. Të gjitha llojet e imunizimit të obliguara me ligj, mamografia, PAPA –testi dhe testi i tuberkulinës;

1.2. Fëmijët deri në moshën 18 vjeçare , nxënësit , studentët deri në moshën 26 vjeçare;

1.3. Shtatzënat dhe shërbimet e lidhura me planifikimin e familjes (përveç ndërprerjes së dhunshme të shtatzënisë pa shkaqe socio-medicinale);

1.4. Personat e moshës mbi 65 vjeçare;

2. Pacientët me sëmundje të rënda kronike dhe sëmundje malinje si :

2.1. Diabetes Mellitus tip 1 (E10);

2.2. Diabetes Mellitus tip 2 insulin vartës (E11);

- 2.3. Insuficienca kronike e veshkëve -Pacientët në dializë (N18);
- 2.4.Tuberkulozi (A15 - A19);
- 2.5. HIV/AIDS (B20 – B24);
- 2.6. Hemofilia (D65 – D69);
- 2.7.Imunodeficienca (D80 – D84);
- 2.8.Sëmundjet malinje (D01 – D09 ; C00 – C97);
- 2.9.Cirroza hepatike (K70 – K76);
- 2.10. LES M32, M05, M06, M07, M34, M45;
- 2.11. Sarkoidoza (D86);
- 2.12. SPOK (J43, J44, J45, J46, J47, J96);
- 2.13. Demenca dhe psikozat kronike, retardimi i rëndë (F00 – F03; F20; F22; F25; F31; F32; F33; F34; F70; F71; F72; F73; F78; F79);
- 2.14. Sëmundjet e Sistemit Nervor (Parkinsonizmi, Skleroza multiple, Epilepsia , Miastenia Gravis, Distrofia muskulare, paraliza infantile spastike, hemiplegjia, paraplegjia, tetraplegjia) (G20, G35, G40, G70, G71, G8-G83);
- 2.15. Personat e verbër dhe të shurdhër (H54; H90; H91);

3. Personat për Fertilizim të Asistuar Mjkësor lirohen nga bashkëpagesa për shërbimet shëndetësore të nivelit tretësor për ciklin e parë dhe ciklin e dytë sipas shtojcës 4 G të këtij udhëzimi.

4. Të gjithë personat me paaftësi si dhe sëmundjet e tjera të cilat i përcakton Ministria e Shëndetësisë.

Neni 9

Bashkë pagesat për shtetasit e huaj

Bashkë pagesat për shtetasit e huaj për kujdes shëndetësor bëhen në kushte të njëjta si edhe qytetarët e tjerë të Republikës së Kosovës.

Neni 10

Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr.04/2007 Mbledhja dhe shfrytëzimi i mjeteve nga bashkëpagesa e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetsore dhe të hyrave vetanake te institucioneve shendetesore.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Prishtinë __/__/2024

Ministri i Shëndetësisë

Dr. Arben Vitia

SHTOJCAT

Shtojca 1: Bashkëpagesat për shërbimet shëndetësore të nivelit parësor

Nr	Lloji i shërbimit	€
1	Ekzaminimi mjekësor në AMF, QMF ose në QKMF, pa analiza laboratorike ose pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë	1.00
2	Vizita e përsëritur mjekësore që ka për qëllim shqyrtimin e rezultateve të analizave laboratorike dhe të ekzaminimeve plotësuese, të kërkuara nga mjeku i institucionit të njëjtë shëndetësor (në periudhën brenda dy javëve).	0.00
3	Vizitat në QMF ose në QKMF e cila realizohet brenda 24 orëve prej momentit të referimit nga Punkti shëndetësor.	0.00
4	Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF me udhëzim të Mjekut të Familjes	2.00
5	Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF pa udhëzim të Mjekut të Familjes	5.00
6	Vizita në shtëpi në thirrjet për kujdes emergjent, NËSE pas vizitës mjeku e konstaton se rasti nuk ka qenë rast urgjent-emergjent	6.00
7	Me përjashtim të rasteve emergjente, qytetarët që kërkojnë shërbime në institucionet e KPSH jashtë zonës së banimit të caktuar nga institucionet përkatëse	5.00
	Ultrazëri standard i realizuar nga specialisti i radiologjisë	2.00
9	Radiografia	2.00
10	Testet laboratorike në situatat e gjendjeve urgjente (psh leukocitet, glikemia , urina etj.)	0.00
11	Analizat laboratorike - vetëm hemogrami (SE, eritrocitet, leukocitet, hematokrit, hemoglobin, trombocite, koha e koagulimit, koha e gjakderdhjes) dhe urina (analiza e përgjithshme, gjaku me lakmues, pamja ngjyra, era, pesha specifike, pH, proteinet ne urine, ketonet, proteina, ekzaminimi mikroskopik i urines së sedimentuar)	1.00
12	Analizat biokimike (glikemia, urea, kreatinini, AST, ALT, bilirubina direkte, bilirubina totale, holesteroli, trigliceridet)	1.00
13	Analizat laboratorike – hemogrami dhe biokimike (SE, eritrocitet, leukocitet, hematocrit, hemoglobin, trombocite, koha e koagulimit, koha e gjakderdhjes) dhe urina; si dhe Analizat biokimike (glikemia, urea, kreatinini, AST, ALT, bilirubina direkte, bilirubina totale, holesteroli, trigliceridet)	3.00
14	Analizat laboratorike T3, T4,TSH	1.00
15	Analizat ASTO, Faktori rheumatoid	1.00
16	Hemoglobina e glukogjenizuar	1.00
17	Fraksionet e yndyrave	1.00
18	Caktimi i sheqerit në gjak me glikometër sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	1.00
19	Elektrolitët	1.00
20	Audiograma	1.00
21	Shpëlarja e veshit	1.00
22	Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërim të plagës (vetëm ne vizitën e parë)	1.00

23	Trajtimi ditor me injeksione dhe infuzione në institucionin shëndetësor	1.00
24	Inhalimi ditor në institucionin shëndetësor	0.50
25	Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	5.00
26	Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive ,etj.-për një orë	25.00

Shtojca 2: Bashkëpagesat për shërbimet shëndetësore stomatologjike të nivelit parësor

Nr.	Lloji i shërbimit	€
1	Vizitë e parë stomatologjike	1.00
2	Vizita kontrolluese	0.00
3	RTG i dhëmbit	1.00
4	Ndalja e gjakderdhjes (urgjencë)	0.00
5	Ndalja e gjakderdhjes postekstraktive (urgjencë)	0.00
6	Mbushje e përhershme me amalgamë	3.00
7	Mbushje e përhershme me kompozitë	4.00
8	Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	4.00
9	Shërimi i alveolitit me seanca	1.00
10	Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	5.00
11	Extirpimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	5.00
12	Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	5.00
13	Extirpimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	5.00
14	Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	5.00
15	Rindërtimi konservativ i dhëmbit me mbushje të përhershme	5.00
16	Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës	1.00
17	Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave	1.00
18	Vulosja e fisurave	1.00
19	Menjanimi i depozitimeve të buta	1.00
20	Menjanimi i depozitimeve të forta (Heqja e gurëzve të dhëmbëve me ultratingull)	3.00
21	Kiretazha e xhepave parodontal (një dhëmbi)	1.00
22	Nxjerrja e dhëmbit	1.00
23	Incizioni intra dhe extra oral	1.00
24	Heqja e kurorës me anë të prerjes	1.00
25	Drenazha e dhëmbit	1.00
26	Riparimi i protezës (ngjitja)	1.00
27	Heqja e penjve	0.00

Shtojca 3: Bashkëpagesat për shërbimet shëndetësore të nivelit dytësor (NUK APLIKOHET PËR PACIENTËT SPITALOR, pos pikës 3 dhe 4)

Nr	Lloji i shërbimit	€
1	Ekzaminimi mjekësor në ambulancën specialistike të spitalit ose në Qendrën për Shëndet mendor, sipas udhëzimit të mjekut nga punkti, QMF, QKMF ose institucioni privat shëndetësor	2.00
2	Ekzaminimi mjekësor në ambulancën specialistike të spitalit ose në Qendrën për Shëndet mendor, pa udhëzim të mjekut nga punkti, QMF, QKMF ose institucioni privat shëndetësor	12.00
3	Qëndrimi në spital vetëm për dhjetë ditë e para (3 euro nata), pastaj pa pagesë	30.00
4	Dita e qëndrimit në spital për personin shoqëruar të pacientit më të vjetër se pesëmbëdhjetë vjeç për tërë kohën e qëndrimit në spital, për çdo ditë	3.00
5	Tomografia e kompjuterizuar – CT	15.00
6	Procedura mjekësore e kryer në mënyrë ambulatorë, Ultrazëri standard	3.00
7	Procedura mjekësore e kryer në mënyrë ambulatorë, Ultrazëri me	5.00
8	Procedura mjekësore e kryer në mënyrë ambulatorë, RTG	3.00
9	Procedura mjekësore e kryer në mënyrë ambulatorë, EKG	1.00
10	Analizat laboratorike për shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore jashtëspitalore	Për këto analiza laboratorike të perdoret cmimorja e nivelit tretësor
11	Përcaktimi i HIV, HBS, HCV	
12	Përcaktimi i T3, T4, TSH	
13	Përcaktimi i Tumormarkerëve – për një tumormarker	
14	Ergometria	5.00
15	Holter monitorimi 24 orësh i EKG -së apo TA	5.00
16	EEG	5.00
17	EMNG	5.00
18	Bronkoskopia	5.00
19	Spirometria	2.00
20	Audiometria dhe vestibulometria	5.00
21	Shpëlarja e veshit	1.50
22	Gastroskopia	5.00
23	Kolonoskopia	5.00
24	Rektoskopia	5.00
25	Cistoskopia	5.00
26	Procedurat mjekësore të kryera në mënyrë ambulatorë: Lavazha e lukthit, klizma, kateterizimi i fshikzës urinare	2.00
27	Tretmani fiziatrik ditor	2.00
28	Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërim të plagës (vetëm në vizitën e parë)	0.00
29	Ndërprerja e shtatzënisë pa indikacion socio-medicinal	50.00
30	Ndërhyrje kirurgjike me anestezi lokal	5.00

31	Ndërhyrje kirurgjike me anesteziion total me laparaskopi në gjinekologji dhe kirurgji si dhe artroscopi në ortopedi	20.00
32	Ndërhyrje kirurgjike me anesteziion të përgjithshëm ose spinal	20.00
33	Detoksikimet e të alkoolizuarve në kushte ambulatorike	5.00
34	Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	5.00

Shtojca 4: Bashkëpagesat për shërbimet shëndetësore të nivelit tretësor – QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVËS

Nr	Lloji i shërbimit	€
1	Ekzaminimi mjekësor në ambulancën specialistike të QKU sipas udhëzimit të mjekut nga Institucioni Regjional i Kujdesit dytësor shëndetësor ose, për komunat e regjionit të Prishtinës, nga punkti, QMF, QKMF ose institucioni privat shëndetësor.	2.00
2	Ekzaminimi mjekësor në ambulancën specialistike të QKU pa udhëzim të mjekut nga Institucioni Regjional i Kujdesit dytësor shëndetësor ose, për komunat e regjionit të Prishtinës, pa udhëzim nga punkti, QMF, QKMF ose institucioni privat shëndetësor.	12.00
3	Vizita konziliare për pacientët jashtëspitalor	10.00
4	Qëndrimi në spital vetëm për dhjetë ditët e para (3 euro nata), pastaj pa pagesë	30.00
5	Dita e qëndrimit në spital për personin shoqëruar të pacientit më të vjetër se 15 vjeq (për tërë kohën e qëndrimit në spital), për çdo ditë	3.00
6	Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	5.00
7	Laringoskopia direkte	5.00
8	Videolaringoskopia	5.00
9	Videolaringostroboskopia	5.00
10	Laringomikroskopia	10.00
11	Otomikroskopia	5.00
12	Rinoplastika estetike	150.00
13	Plastika e lapres se veshit - estetike	80.00
14	Endoskopia e hundës	5.00
15	FEES	10.00
16	Audiometria objektive	5.00
17	Audiometria tonale (Audiograma)	2.00
18	Vestibulometria	2.00
19	Shpëlarja e veshit	2.00
20	Timpanogrami	2.00
21	Testi kalorik	2.00
22	Tamponada e përparme	2.00
23	Tamponada e pasme	2.00
24	Tracheobronchoskopia me anesteziion të përgjithshëm	15.00
25	Direktoskopia (DSK)	2.00

26	Kauterizimi	2.00
27	Intervenimet e vogla me qepje	2.00
28	Toaletë + lidhje me ndërrim fashe	1.00
29	ESK në anestezi të përgjithshëm	15.00
30	ESK (Ezofagoskopia) në anestezi lokal + buzëhimi	10.00
31	ENG (Elektronistagmografia)	10.00
32	EEG	5.00
33	EMNG	5.00
34	Laserofotokoagulimi	10.00
35	Spirometria	3.00
36	EKG	1.00

Radiologjia

Nr	Lloji i shërbimit	€
1	Tomografia e kompjuterizuar (CT)	15.00
2	Rezonanca magnetike (RM)	20.00
3	Echo (ultrazëri) – i abdomenit, urotraktit, gjendres tiroide dhe të regjioneve tjera	5.00
4	Ultrazëri me Doppler color	10.00
5	Ekokardiografia tranzesofageale	10.00
6	Rtg nativ	2.00
7	Rtg me kontrast	10.00
8	Histerosalpingografia	10.00
9	Biopsitë me UZ	5.00
10	Infiltrime (bllokadë kurrizit)	20.00
11	PTCB	80.00
12	Nefrostoma	80.00
13	Drenimi abscesive	20.00
14	Biopsit me CT	20.00
15	Galaktografia	10.00
16	Biopsi me lokalizim me tel mamografi	10.00
17	Biopsi me lokalizim me tel ultrazë	10.00
18	Mamografia	0.00

Klinika e Reumatologjisë

Nr	Lloji i shërbimit	€
1	Vizita ambulatore	4.00
2	Punksion artikular	2.00
3	Injektim intra artikular	3.00
4	Infiltrim për artikular dhe në inde të buta	3.00
5	Terapia ditore	4.00
6	Komisionet konsiliare brenda klinikes	10.00

Mjekësia nukleare

Nr	Lloji i shërbimit	€
1	T3, T 4, TSH, ANT, TG, ANTATPO, TG	5.00
2	Scintigrafia	10.00
3	Terapia me J 131	10.00
4	DEXA	10.00
5	SPECT/CT	30.00
6	PET/CT	30.00

Shërbimi i Alergologjisë me Imunologji klinike

Nr	Lloji i shërbimit	€
1	Testet kuktane Inhalatore	3.00
2	Testet kutane ushqimore	3.00
3	Patch testi	3.00

Instituti i Anatomisë Patologjike

Nr	Lloji i shërbimit	€
1	Biopsia	5.00
2	Punksioni citologjik (FNA) dhe strishoja citologjike për cdo analiz	5.00
3	PAP test	1.00
4	Analiza Histokimike	10.00
5	Analiza Imunohistokimike	20.00
6	SISH (Silver enhanced in situ Hibridizim)	30.00
7	Testim molekular	30.00
8	Konsulta nga jashtë	5.00
9	Autopsia për pacientat e jo hospitalizuar	50.00
10	Morgu për pranimet jo të hospitalizuara	20.00

Instituti i Fiziologjisë Patologjike

Nr	Lloji i shërbimit	€
1	Ekzaminimet funksionale specialistike të sistemit respirator	3.00
2	Analiza e spirometrisë dhe komentime	3.00
3	Inhalime/ Teste të bronkodilatimit me salbutamol	3.00

Instituti i Biokimisë

Nr	Lloji i shërbimit	€
1	Analizat laboratorike hematologjike dhe biokimike për shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore jashtëspitalore - në bllok	3.00
2	Tumormarkerët - sipas organit	2.00

Analizat Citogjenetike

Nr	Lloji i shërbimit	€
1	Për çdo analizë	5.00

Sherbimi i Hematologjisë

Nr	Lloji i shërbimit	€
1	Hematokriti, Hgb, Le, Tr, Er	3.00
2	Strishoja e gjakut periferik me koment	5.00
3	Biopsia e palcës kockore	15.00
4	Punksioni i palcës kockore me interpretim	10.00
5	Transfuzioni i gjakut	5.00
6	Venepunksioni	2.00

Shërbimet e Klinikës së Endokrinës

Nr	Lloji i shërbimit	€
1	Ultrazeri i Tiroides	5.00
2	FNAB	5.00
3	Debridment (seanca)	5.00
4	Vendosja e CGM	3.00
5	Vendosja e pompës insulinike	3.00
6	Edukimi diabetik (seanca)	2.00

Sherbimi i Gastroenterologjisë me Hepatologji

Nr	Lloji i shërbimit	€
1	Ezofagogastroduodenoskopia	5.00
2	Rektoskopia	5.00
3	Sigmoidoskopia	5.00
4	Ligatura—sklerozimi i hemoroideve	5.00
5	Gastroskopi me biopsi	30.00
6	Gastroskopi me anestezion	30.00
7	Gastroskopi urgjente	0.00
8	Vendosja e balonit intragastrik	100.00
9	Largimi i balonit intragastrik	100.00
10	Dilatim i Ezofagut	100.00
11	Hemostaze endoskopike (Gastroskopi me injektim te adrenalines per ndalje te gjakderdhjes)	75.00
12	Vendosja e klipsave (Gastroskopi me vendosje te klipave per hemostaze)	100.00
13	Vendosja e klipave Ovesco (per ndaljen e gjakderdhjes)	100.00
14	Ligature e varikseve	100.00
15	Largimi i trupave te huaj nga ezofagu,lukthi	50.00
16	Polipektomi ne lukth	75.00
17	EUS-i (ultrazeri endoskopik) diagnostik (dhe me biopsi)	150.00 (250.00)
18	Videokapsule endokopia	150.00
19	Kollonoskopia	30.00
20	Kollonoskopi me biopsi	40.00
21	Kollonoskopi me anestezion	40.00

22	Kollonoskopi urgjente	40.00
23	Polipektomi ne kolon	75.00
24	Vendosja e endollupit ne kollon	75.00
25	Largimi i trupave te huaj nga rektumi	25.00
26	Reponimi i hemoroideve	25.00
27	ECHO abdominale	5.00
28	Punksioni abdominal	10.00
29	Tushe rektale	10.00

Shërbimi i Kardiologjisë

Nr	Lloji i shërbimit	€
1	Ergometria	5.00
2	Holter monitorimi 24 orëshi EKG-së apo TA	10.00
3	Pericardiocenteza	10.00
4	“Pace maker” i përkohshëm	30.00
5	“Pace maker” i përhershëm	50.00

Kardiologjia Invazive

Nr	Lloji i shërbimit	€
1	Kateterizimi i zemrës se djathte:	
	a. Ventrikulografia	50.00
	b. Matja e shtypjes ne sistemin venoz qendror dhe arterial pulmonar	30.00
	c. Llogaritjet hemodinamike	40.00
2	Kateterizimi i zemrës se majte - ventrikulografia	40.00
3	Arteriografia e arterieve periferike	20.00
4	Pulmonare	20.00
5	Cerebrale	20.00
6	Renale	20.00
7	Aortografia	20.00
8	Koronarografia - me implantim të stentit (pavarësisht numrit të stentave të vendosur)	200.00
9	Koronarografia - me balonim;	100.00
10	Koronarografia pa stentim apo balonim;	70.00
11	Venografia periferike	30.00
12	Venografia qendrore	40.00
13	EPS pa ablacion	100.00
14	EPS me ablacion te takikardi supraventrikulare (AVNRT, AVRT, FAT, flater)	150.00
15	Ablacion për fibrilim atrial (izolimi i venave pulmonare)	200.00
16	Ablacion për ESV ose/dhe takikardi ventrikulare	200.00
17	Testimi i pajisjes Pacemaker (VVI, DDD), ICD (VVI, DDD), CRT-D ose CRT-P	4.00
18	Pacemaker VVI	120.00
19	Pacemaker DDD	130.00

20	Pacemaker biventrikular (CRT P)	150.00
21	ICD VVI	200.00
22	ICD DDD	220.00
23	CRT-D	200.00

Shërbime tjera

Nr	Lloji i shërbimit	€
1	Ndërprerja e shtatzënisë pa indikacion socio-medicinal	50.00
2	Ndërhyrje kirurgjike me anestezion lokal	10.00
3	Ndërhyrje kirurgjike me anestezion total me laparoskopë në gjinekologji dhe kirurgji si dhe artroskopë në ortopedi	20.00
4	Ndërhyrje kirurgjike me anestezion të përgjithshëm ose spinal	20.00
5	Tretmani fiziatrik ditor për pacientët jashtëspitalor (përfshirë të gjitha procedurat)	2.00
6	Detoksikimet e të alkoolizuarve në kushte ambulatorike	5.00

Klinika e Ortopedisë

Nr	Lloji i shërbimit	€
1	Endoproteza totale e gjurit	250.00
2	Endoproteza totale e kerdhokulles	300.00
3	Endoproteza parciale e kerdhokulles	150.00
4	Ligamentoplastka e gjurit	100.00
5	Qepja e meniskusit	50.00
6	Implantimi i shtiftit intramedullar ne kocka	40.00
7	Implantimi i pllakes ne kocka	50.00
8	Implantimi i vidave dhe telave te Kirshnerit	25.00
9	Implantimi i vidave ne bosht kurrizor	150.00
10	Heqja e materialit otesintetik	50.00

Klinika e Kirurgjisë Maksillofaciale

Nr	Lloji i shërbimit	€
1	Egzaminimi specialistik	5.00
2	Incizion extraoral dhe vendosja e drenit	5.00
3	Incizion intraoral i abcesit dhe vendosja e drenit	7.00
4	Incizioni extraoral joodontogjen dhe vendosja e drenit	7.00
5	Nxerrja e dhembit me anestezion te pergjithshem	20.00
6	Reimplantimi i dhembit	10.00

7	Repozicioni kirurgjik i dhembit	5.00
8	Hemostaza e alveoles pas nxerrjes se dhembit, me tamponim	10.00
9	Hemostaza pas nxerrjes se dhembit me suture	10.00
10	Hemostaza biologjike dhe kimike pas nxerrjes se dhembit	10.00
11	Imobilizimi monomaksillar	20.00
12	Replantimi i dhembit dhe imobilizimi monomaksillar	30.00
13	Imobilizimi bimaksillar	50.00
14	Imobilizimi bimaksillar elastik	50.00
15	Imobilizimi bimaksillar fiks	20.00
16	Imobilizimi i perkohshem sipas Ivy	30.00
17	Reponimi i kockes zygomatike me kuke	60.00
18	Osteosinteza e kockes malare me pllaka	100.00
19	Suspensiononi circumzygomatik unilateral	60.00
20	Suspensiononi circumzygomatik bilateral	100.00
21	Osteosinteza e margos inferior te orbites ma pllaka	60.00
22	Osteosinteza e kulmit te orbites me pllaka "Broën incision"	60.00
23	Reponimi dhe fiximi i ligamentit kntal medial	100.00
24	Reponimi dhe fiximi i ligamentit kantal lateral	100.00
25	Osteosinteza e trupit te mandibules me pllaka	100.00
26	Osteosinteza e trupit te mandibules me pllaka me qasje extraorale	100.00
27	Osteosinteza e trupit te mandibules me qasje extraorale dhe graftim kockor	100.00
28	Osteosinteza te frakturat e dyfishta ne trupin e mandibules	100.00
29	Osteosinteza e collum mandibulae me pllaka	100.00
30	Osteosinteza e fracturave diakapitulare ne koken e mandibules me vida	100.00
31	Osteosinteza e fracturave te ulta te collum mandibulae me qasje retromandibulare	100.00
32	Osteosinteza e fracturave Le Fort I	100.00
33	Osteosinteza e fracturave te maxilles Le Fort II	100.00
34	Osteosinteza e fracturave te maxilles Le Fort III	100.00
35	Osteosinteza e fracturave dentoalveolare	30.00
36	Supensiononi circummandibular	70.00
37	Largimi i pllakave te osteosintezes	70.00
38	Rekonstruksioni i dyshemes se orbites me graft kockore	100.00
39	Rekonstruksioni i dyshemes se orbites me rrjete metalike	120.00
40	Rekonstruksioni i mureve te tjera te orbites me graft kockore	120.00
41	Diseksioni radikal i qafes i nje aneshem	120.00
42	Diseksioni radiakal i qafes i dyanshem	150.00
43	Diseksioni elektiv i qafes i nje anshem	130.00
44	Diseksioni i elektiv i qafes i dy anshem	150.00
45	Diseksioni funksional i qafes i nje anshem	120.00
46	Diseksioni i funksional i qafes i dyanshem	150.00
47	Maxillectomia parciale	60.00

48	Maxillectomia subtotale	80.00
49	Maxillectomia me exenterim te orbites	150.00
50	Maxillectomia parciale me rekonstruksion kockore	200.00
51	Maxillectomia parciale me rekonstruksion me bukal fat pad	150.00
52	Maxillectomia totale	120.00
53	Maxillectomia totale me ethmoidectomi	120.00
54	Resekcioni marginal i mandibulles	80.00
55	Resekcioni segmental i mandibulles	100.00
56	Hemimandibulecomia me rekonstruksion e pllaka rekonstruktive	120.00
57	Excisioni i tumorit te lekures ne fytyre dhe mbyllja me suture direkte e defektit	30.00
58	Excisioni i tumorit lekuror dhe rekonstruksioni i defektit me llambo lokale	50.00
59	Excisioni i tumorit ne fytyre dhe rekonstruksioni i defektit me grafte lekurore ne anetesion total	70.00
60	Excisioni i tumorit ne qafe dhe mbyllja e defektit me llabo regjionale pectoralis major	150.00
61	Biopsia e tumorit ekstraoral	30.00
62	Biopsia e tumorit intraoral	30.00
63	“V” ekscizioni u buzes se siperme	80.00
64	“V” ekscizioni u buzes se poshtme	80.00
65	“Ë” ekscizioni u buzes se siperme	100.00
66	“Ë” ekscizioni u buzes se poshtme	100.00
67	Parotidectomia superficiale	120.00
68	Parotidectomia totale me preservim te nervit facial	150.00
69	Parotidectomia totale radikale pa preservim te nervit facial	120.00
70	Parotidectomia me resekcion te kockave perreth	150.00
71	Biopsia e nyjes limfatike	30.00
